



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTOIRIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

RREGJISTRI I KËRKESAVE PËR INFORMACION

Periudha Tetor-Dhjetor 2023

Nr rendor (1)	Data e kërkesës (2)	Objekti i kërkesës (3)	Data e përgjigjes (4)	Përgjigje (5)	Mënyra e përfundimit të kërkesës (6)	Tarifa (7)
1	11.10.2023	<p>1. Vendndodhjen e pronave që ka nën zotërim Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë në Bashkinë Himarë.</p> <p>2. Sipërfaqen specifike për secilën pronë të specifikuar në Himarë.</p> <p>3. Njollën e sipërfaqes.</p> <p>4. Objektet në këto prona.</p>	11.10.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, të ardhur nëpërmjet e mailit më datë 11.10.2023, ju informojmë se institucioni ynë nuk disponon të dhëna mbi pronat e individëve apo subjekteve ekonomike privat. Për rrjedhojë për të marrë përgjigjen e kërkuar ju lutem ti drejtoheni Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.</p> <p>Ju faleminderit!</p>	E përfunduar	Jo
2	12.10.2023	<p>1.Listën e institucioneve publike që funksionojnë brenda territorit të Bashkisë Himarë dhe adresat respektive (banesa kolektive: shtëpitë e të moshuarve, shtëpitë e fëmijëve, institucionet për personat me aftësi të kufizuar, qendrat rezidenciale studentore, qendrat sociale rezidenciale);</p> <p>2.Listën e organizatave jofitimprurëse, fondacioneve dhe organizmave të tjerë të ngjashme që ushtrojnë aktivitetin brenda</p>	25.10.2023	<p>Lidhur me kërkesen e dërguar nëpërmjet emailit me datë 12.10.2023, ju bejme me dije se:</p> <p>Prane Bashkisë Himarë është ngritur sektori i strehimit i cili merret me procedurat e individëve që janë të pastreh ose kanë probleme me banesat e tyre (te renuar ose janë shumë të amortizuara). Në këtë sektor administrohen kërkesat të cilat merren parasysh për të hartuar shërbime në interes për nevojat që kanë qytetarët.</p>	E përfunduar	Jo

		territorit të bashkisë suaj dhe adresat respektive (që janë për qëllime banimi); 3. Identifikimin e të pastrehëve dhe vendqëndrimet e tyre;		Per vitin 2023 jane administruar 4 kerkesa te familjeve per strehim social ku banesat e tyre ka qene shume te amortizuar. Gjithashtu nga skuadra e terrenit nuk jane identifikuar endacak apo te pastreh ne territorin e bashkise. Ne territorin e Bashkise Himare nuk ka qendra rezidenciale per kategori te ndryshme te individeve gjithashtu nuk ka OJF apo streheza te cilat veprojne dhe funksionojne per njerezni ne nevoje.		
3	17.10.2023	Nga informacionet që kemi në terren, në vijën bregdetare të fshatit Dhërmi po realizohet një ndërhyrje në det për ndërtimin apo zgjatimin e një strukture në det në afërsi të resortit “Drymades Inn”. Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji për të drejtën e informimit Nr.114/2014, emisioni “Vetting” kërkon si informacion: 1.A ka leje zhvillimi subjekti që po kryen ndërhyrjen në det? 2. Nëse po, ju lutemi të na vendosni në dispozicion lejen e zhvillimit nga subjekti.	20.10.2023	Per sa i perket ndertimeve ne vendin qe ju i jeni referuar ju bejme me dije se ndertimet ne zonen ujore te detit ne plazhin e Dhermiut jane jashte kopetences se veprimit per dhenie leje te Bashkise Himare. Kjo pasi eshte kopetence te Keshillit Kombetar te Territorit per dhenien e lejeve per strukturat qe opertojne ne ujerat detare. Megjithate ne iu drejtuam IMT prane Bashkise Hkmare per kete ndertim per marrjen e infomacionit mbi keto punime. Bashkengjitur do te gjeni materialin informues per keto punime.	E përfunduar	Jo

4	17.10.2023	1.Njollën e shtrirjes për të gjitha subjektet që kanë leje minerare shfrytëzimi në Bashkinë Himarë.	26.10.2023	Ne pergjigje te kerkeses tuaj te ardhur me email date 17.10.2023 po ju veme ne dispozicion koordinatat e subjekteve qe disponojne leje minerare shfryteziimi.		
5	23.10.2023	Qendra Res Publica është e angazhuar ti shërbejë publikut për të bërë transparencën e institucioneve e cila ndikon drejtëpërsëdrejti në mirëqeverisjen e vendit. Në shërbimin online www.publeaks.al ka mbërritur kërkesa e një qytetari për tu informuar në lidhje me: 1.Kur kanë filluar punimet për ndërtimin e “Ndërtimi i veprës së marrjes dhe linjës së transmetimit të ujit nga Lepusha në Himarë”? 2.Cilët janë personat e caktuar për zbatimin e projektit, mbikqyrësi dhe koalidatori i punimeve? 3.Kur kanë filluar punimet për ndërtimin e “Rrjetit shpërndarës i ujës jellësave për fshatrat Borsh, Qeparo, Himarë fshat, Jalë, Vuno, Livadh dhe Himarë qytet”?	01.11.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj ju informojnë se objekti “Ndërtimi i veprës së marrjes dhe linjës së transmetimit të ujit nga Lepusha në Himarë” janë projekte që synojnë të furnizojnë me ujë zonat e përfshira në programin e ujësjellësave ruralë, program i cili zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Për sa më sipër ju lutem që infomacionin e kërkuar ti drejtoheni Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Ju bëjmë me dije se gjithashtu se bazuar në kodin e procedurave kërkesa juaj do të përcillet institucionit kopetent edhe nga ana jonë nëpërmjet e-mailit.	E përfunduar	Jo

		4.Cilët janë personat e caktuar për zbatimin e projektit, mbikqyrësi dhe koalidatori i punimeve?				
6.	30.11.2023	<p>1.Në vijim të kërkesës së mëparshme të drejtuar nga shoqëria "Pastrime Silvio" shpk, për zbatimin e vendimit nr.145 (31132-01732-86-2022) akti, nr. 64 (86-2023-920) vendimi, datë 25.09.2023 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga ana e Bashkisë Himarë. Me anë të kësaj kërkesë për informacion, kërkojmë një informacion lidhur me veprimet që ka ndërmarrë Bashkia Himarë për zbatimin e vendimit të sipërcituar të gjykatës dhe në çfarë faze ndodhet aktualisht. Si subjekt që prekemi drejtpërdrejt nga zbatimi i këtij vendimi të gjykatës, lutemi të na informoni sa më shpejt që të jetë e mundur lidhur me sa kërkojmë.</p>	12.12.2023	<p>Shoqëria PASTRIME SILVIO shpk i është drejtuar Bashkisë Himarë nëpërmjet kërkesës datë 30.11.2023 ku kërkon informacion mbi zbatimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Nr. 64 (86-2023-920), datë 25.09.2023</p> <p>Sqarojmë se Gjykata Administrative e Apelit nëpërmjet vendimit Nr. 64 (86-2023-920), datë 25.09.2023. ka vendosur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë; - Shfuqizimin e Vendimit Nr. 474/2022, datë 16.05.2022 të Komisionit të Prokurimit Publik; - Detyrimin e Komisionit të Prokurimit Publik të marrë masa për kthimin në buxhetin e shtetit të tarifës administrative të parapaguar nga ankuesi Bashkimi i Operatorëve Ekonomik Shoqëria tregtare "Alko Impex General Construction" d.sh.h dhe shoqëria tregtare "Alko Impex Construction" sh.p.k.; - Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera; 	E përfunduar	Jo

			<p>- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur;</p> <p>- Ky vendim përbën titull ekzekutiv, menjëherë të ekzekutueshëm nga Shërbimi Përmbarrimor Gjyqësor;</p> <p>- E drejta e rekursit kundër këtij vendimi mund të ushtrohet në Gjykatën e Lartë, brenda 30 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.</p> <p>Theksojmë se kërkesa padia e shoqërisë PASTRIME SILVIO shpk dhe & AEK& KO shpk ka patur për objekt.</p> <p>- Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar efektet e aktit administrativ Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 474/2022, datë 16.5.2022;</p> <p>- Shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 474/2022, datë 16.5.2022;</p> <p>- Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të datës 19.4.2022, si dhe Njoftimin e Fituesit të datës 21.4.2022 të autoritetit kontraktor Bashkia Himarë;</p> <p>- Shfuqizimin e marrëveshjes kuadër apo çdo kontrate që mund të lidhë autoriteti</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>kontraktor me bashkimin e operatorëve ekonomik “Alko Impex General Construction” dshh dhe shoqëria “Alko Impex Construction” shpk, gjatë gjykimit të kësaj kërkesë padie.</p> <p>Sa më sipër, rezulton se Gjykata ka shfuqizuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik por në asnjë rast nuk ka shfuqizuar ndonjë akt të autoritetit kontraktor Bashkia Himarë apo të ketë urdhëruar Bashkinë Himarë për kryerjen e ndonjë veprimi tjetër.</p> <p>Në pjesën arsyetuese të vendimit të Gjykata Administrative e Apelit nëpërmjet vendimit Nr. 64 (86-2023-920) datë 25.09.2023, gjykata lidhur me kërkimet e tjera të paditësit në kërkesëpadi është shprehur se lidhur me zgjidhjen e pasojave të shfuqizimit të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik gjykata konstaton se duhet bërë vetëm kthimi i tarifës së paguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga bashkimi operatorëve ekonomik “Alko Impex General Construction” d.sh.h dhe shoqëria tregtare “Alko Impex Construction” sh.p.k.</p> <p>Përsa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit nuk ka ngarkuar me asnjë detyrë apo detyrim Bashkinë Himarë për kryerjen e ndonjë veprimi.</p>		
--	--	--	---	--	--

				Duke ju uruar punë të mbarë,		
7.	11.12.2023	<p>1. A është konsultuar me publikun Buxheti Vjetor 2023 dhe 2024 i Bashkisë? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjesave publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.</p> <p>2. A është konsultuar me publikun paketa e taksave dhe tarifave vendore për periudhën 2023-2024? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjesave publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.</p> <p>3. A është konsultuar me publikun tjetërsimi i pronave të Bashkisë për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjesave publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të</p>	20.12.2023	<p>Per pyetjen e pare dhe te dyte do ti gjeni bashkengjitur dokumentacionin perkates:</p> <p>3. -Jo nuk eshte konsultuar me publikun per tjetersimi i pronave.</p> <p>4.- Po jane njoftuar ne faqen e internet te institucionit. Me poshte do te gjeni linkun si dhe procesverbalet:</p> <p>https://himara.gov.al/mbledhjet-e-keshillit-bashkiak-2023/</p> <p>5. - Po jane njoftuar. Me poshte do te gjeni njoftimet perkatese:</p> <p>6. -Po me poshte do te gjeni link per degjesat publike nga Keshilli Bashkiak:</p> <p>https://himara.gov.al/konsultime-publike-keshilli-bashkiak/</p> <p>7. -Bashkia Himare per here te pare aplikoji per fond social per 2023 dhe nuk e fitoi. Aplikimi konsiston ne mbeshtetje per</p>	E përfunduar	Jo

	<p>procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.</p> <p>4. A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.</p> <p>5. A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Komisioneve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023?Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.</p> <p>6. A shfaqen në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike, njoftime për organizimin e Dëgjesave Publike nga Këshilli Bashkiak për periudhën Janar 2023- Dhjetor 2023? Nëse po, më përcillni kopje të</p>		fond per sherbim levizes per individet ne nevoje .		
--	--	--	--	--	--

		<p>njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre dëgjësive, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.</p> <p>7. A ka qenë Bashkia juaj ndonjëherë përfituese e Fondit Social që nga krijimi i tij dhe nëse po, sa ka qenë periudha për të cilën është ofruar mbështetje dhe në çfarë vlerë monetare?</p>				
8.	26.12.2023	<p>1. Lutemi të na informoni në çfarë faze janë përgatitjet për ndërtimin e rrugës së Tërbaçit, premtimi kryebashkiakut Jorgo Goro. A ekziston një projekt për rrugën? Nëse po lutemi ta ndani me ne. Sa pritjet të kushtojë projekti? Kur parashikohet të nisë puna? Kur pritjet të përfundojë ndërtimi I rrugës në fshatin Tërbaç?</p> <p>2. Lutemi të na informoni a ka bashkia Himarë një plan për ndërtimin e rrugës në Kudhës që e lidh atë me rrugën e Lumit të Vlores sipas premtimit të kryebashkiakut Jorgo Goro? Në çfarë faze janë përgatitjet për ndërtimin e kësaj rruge. A ekziston një projekt për rrugën? Nëse po lutemi ta</p>	29.12.2023	<p>1-Per sa i përket rruges që fillon në rrugën nacionale Vlore-Qeparo dhe fshatit Terbac ju informojmë kryetari i bashkisë Himarë është kujdesur që në momentin kur po realizohej rruga e lumit të Vlores që të bente projektin e rrugës lidhëse të fshatit Terbac. Ky projekt është pjesë e arkives teknike të Bashkisë Himarë dhe ben pjesë një nga prioritetit kryesore të qendres Administrative Hor-Vranisht miratuar nga me vendim të keshillit bashkiak. Qe në momentin e realizimit të këtij projekti dhe në vijim kemi kërkuar mundësinë për financimin e këtij projekti me buxhet shteti apo me financime të tjera të njohura por deri tani nuk është mundur të gjejmë një financim të suksesshem , kjo ndodhur pasi Bashkia Himarë e ka të pamundur ta financojë me buxhetin e ve.</p>	E përfunduar	Jo

		ndani me ne. Sa pritet te kushtoje projekti? Kur parashikohet te nise puna? Kur pritet te perfundoje ndërtimi i rrugës ne fshatin Pilur?		Bashkengjitur po ju dergojme infomacione teknike mbi projektin e rreges Terbac. 2-Per sa i perketet pikes se dyte nuk jemi te qarte per cfare rruge behet fjale pasi rruga e re e lumit te Vlores dhe pikerisht segmenti Kuc-Qeparo kalon ne fshatin Kudhes dhe gjeografikisht nuk eshte e nevojshme realizimi i nje rruge lidhese. Nese ju beni fjale per rruget e brendshme te fshatit apo aksin kryesor qe kalon neper fshat Bashkia e Himares do te ket prioritetet e saj rikualifikimin e rrugeve te brendshme te ketij fshati. Vlen te permendet se ne fshatin Kudhes jane realizuar 2 lote si investin ne infrastrukture per rehabilitimin e sheshit te qendres duke restauruar dhe fasadat pjese perberese se ketij sheshi dhe njekohesisht restaurimin e shtepive dhe infrastruktures perkatese ne lagjen e siperme te fshatit si nje lot i dyte i investimeve e cila eshte nje shembull shum i mir per vijemesine per zonat e tjera te ketij fshati. Per sa i perket perfundimi i rruges se fshatit Pilur pritet te perfundoje ne Janar 2024.		
9.	27.12.2023	1.Sa punonjës janë në pozicionin e koordinatorit vendor, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në juridiksionin e bashkisë tuaj?	29.12.2023	Faleminderit që keni dërguar kërkesën për informacion mbi rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare. Kjo është një	E përfunduar	Jo

		<p>2.Në sa raste (përgjatë viteve 2018, 2019, 2020 , 2021, 2022, 2023) koordinatori ka bashkëpunuar me policinë e shtetit (në sa raste titullari i policisë së shtetit ka njoftuar menjëherë koordinatorin për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare)?</p> <p>3. Sa qendra sociale të rehabilitimit janë ngritur pranë juridiksionit të bashkisë tuaj, për viktimat e dhunës në familje?</p> <p>4. Sa struktura të qendrave publike janë për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve pranë juridiksionit të bashkisë tuaj?</p> <p>5. A keni bashkëpunuar me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes?</p>		<p>çështje e rëndësishme dhe e ndjeshme për ne si institucion.Në zbatim të angazhimit tonë në drejtësi dhe mbrojtjen e individëve, si dhe për të dokumentuar dhe për të monitoruar rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare ne i referohemi sistemitRevalb. Për t'iu përgjigjur pyetjeve si mëposhtë po ju bëjmë me dije se :</p> <p>Në juridiksionin e bashkisë është vetëm një punonjës koordinator vendor përdhunën në marrëdhënie familjare me profesion punonjëse sociale, e trajnuar për këtë funksion si dhe e kryen këtë funksion prej 4 vitesh.</p> <p>Që prej 2019-2023 janë regjistruar 84 raste dhune, ku 20 prej tyre janë meshkuj dhe 64 janë femra ku 8 prej rasteve kanë qënë dhe femijë. Bashkia Himare nuk ka streheza apo qendra te tjera qe ofrojne sherbime per dhunuesit dhe viktimat e mbijetuara te dhunes dhe rastet i referojme ne sherbimet qe qyteti i Vlores ka.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>Bashkëpunim të ngushtë bashkia ka me shërbimin e provës dhe komisariatit e policisë për moonitorimet e urdhrave të mbrojtjes.</p> <p>Ju falënderojmë për interesimin tuaj për këtë çështje të rëndësishme dhe jemi të gatshëm të ndihmojmë sa të mundemi në zbatimin e politikave dhe masave për mbrojtjen dhe ndihmën e personave të prekur.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

Shënim:

1-Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

2-Data e regjistrimit të kërkesë

3-Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

4-Data e kthimit të përgjigjes

5-Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

6-Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

7-Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.